



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:000497

Datë: 09.02.2021

Numri i dokumentit: 01489928

PKR.NR.108/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Dafina Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. Zh. nga K. ... me banim në rr. “.....” nr. 21, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i përgjithshëm (tani në kompetencë të departamentit për Krime të Rënda), PP/II.nr.3043/19 të dt.26.12.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Haxhi Sinani, të akuzuarit S. Zh. , me dt. 04.02.2021 mori dhe me dt.09.02.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

S. Zh. , i biri i L. dhe nënës L. e gjinisë H., i lindur me dt. në Rep, ndërsa tani me vendbanim ne ne rr. “ “ nr. 2 , i pa martuar, ka të kryer shkollën mesme, kamarier , i gjendjes së mesme ekonomike, nr. personal, shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt. 15.12.2019, rreth orës 16.20, në rr.”” K....., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr. 05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë : një Sprej me mbishkrimin, ngjyrë e gjelbër dhe një fishekë kal. 7.62mm, në atë mënyrë që në ditën kritike gjersa Policia e Kosovës kanë bastisur kontrolluar shtëpinë e të pandehurit S. Zh. në dhomën e tij policia kanë gjetur dhe konfiskuar sprejin me të dhënat e lartcekura,

-Me çka ka kryer vepër penale, mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Andaj , gjykata konform nenit 7,38,39,40,43,69,70, dhe nenit 366 par.1. të KPR të Kosovës,nenit 365 të KPPR të Kosovës, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit i cakton dënim me gjobë në lartësi prej 200€ (dyqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3(tre)muajsh, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës.

Konfiskohet një Sprej me mbishkrimin, ngjyrë e gjelbër dhe një fishekë kal. 7.62 mm të ruajtura sipas rastit policor 2019-DA-2585 dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tredhjet euro), si dhe shumën 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të viktimave, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.3043/19 të dt. 26.12.2019, kundër të akuzuarit S. Zh. nga K-....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prokuroria themelore në Pejë bashkë me aktakuzë në gjykatë ka dërguar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë

Me dt.04.02.2021, gjykata ka daktuar seancën dëgimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ku dhe janë prezantuar prokurori i shtetit Haxhi Sinanaj, i akuzuari S. Zh. dhe mbrojtësi i tij av. Filloreta Hoxha është bërë e ditur përkatësisht është konfirmuar se: i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit me dt. 20.12.2019 kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të njëjtën marrëveshje sërish e kanë konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, dhe këtë marrëveshje gjyqtarja e ka pranuar – e bindur thellë se marrëveshja e tillë është bërë konform dispozitave të Kodit të procedurës Penale dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Pasi që u aprovua përkatësisht u pranua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë gjyqtarja e konfirmoj edhe vendimin mbi dënimin ashtu siç është arritur edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Po ashtu u sekuestrua spreji dhe një fishekë të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Gjykata konfirmoi nenit 450 të akuzuarin e obligon në paguarjen e shpenzimeve procedurale.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,
2020:000497, 09.02.2021**

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.